



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021, mori në shqyrtim praktikatat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 41, datë 06.03.2020, për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec-et: “Backa 1” me kapacitet të instaluar 1600 kW, Hec “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kW, Hec “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kW, Hec “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kW, Hec “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kW, me kapacitet total të instaluar 7320 kW.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, date 06.12.2011, të bordit të komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të bordit të komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “Kurum Interntional” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec-i “Ulez” me kapacitet të instaluar 24 MW.
4. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Shkurt 2021.
5. Mbi miratimin e “Rregullave operacionale për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror”.
6. Për miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënien e të drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror.
7. Mbi miratimin e objektivave strategjike të ERE për periudhën 2021 - 2023.